



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.369/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal Arta Curri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, paraqitur kundër anëtarit të Qendrës së Votimit nr. 3302/02 dhe 3304/01 të Hanit të Elezit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal Arta Curri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, me shenjën ZL.Anr.369/2017 e datës 23.10.2017, e paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal Arta Curri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ka pretenduar se në Qendrat e Votimit nr. 3302/02 dhe 3304/01, në Han të Elezit, dyshohet për manipulim votash gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit.

Më tej ka theksuar se as votat e familjarëve të saj, të konfirmuara nga ana e tyre nuk janë në kutit e votimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal Arta Curri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesja e ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.369/2017 më datën 24.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.